

Ne lidhje me pyetje e parashtruara ne email tuaj (mosdeklarimi I parave ne kufi), ju bejme me dije se:

- Në lidhje me pyetjen e pare vlerat e sekuestruara janë (vetem nga Drejtoria Antitrafik - DPD):

Viti 2022	Janar – 20 Qershor 2023
1.301.349 EUR	909.505 EUR
164.790 GBP	315.890 GBP
1.850.600 ALL	139.900 USD
	22.480 CHF
	41.500 ALL

Sjellim nje rast - Nga Drejtoria e Antikontrabandës, ne datë 11.05.2023, grupet e AK/Tokësore, me shërbim zona doganore Durrës, gjatë kontrollit të ushtruar në mjetin me targa angleze, evidentuan 10,000 GBP të padeklaruara, duke njoftuar strukturën e Antitrafikut dhe hetimit doganor DPD.

Për mos deklarim të parave cash, ndaj subjektit shkelës u aplikua penalitet, në masën 20,000 lekë.

Sa i përket pyetjes së dytë vlen për tu theksuar se DPD nuk disponon nje informacion të plotë perfundimtar se kush është vëndi i origjinës ose destinacioni final i parave të trafikuar. Rastet më të shumta në varësi të linjave të udhëtimit ajrore, tokësore apo detare (te konstatuara nga DPD) janë nga Anglia, Italia, Greqia, Kosova dhe Turqia.

Kur konstatohet mosdeklarimi ose deklarimi i rremë, paralelisht me vendosjen e gjobës nga Administrata Doganore, trajtimi i rastit bëhet sipas dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Per kete pyetje duhet ti drejtoheni organeve te sipercituara per shkak te kompetences qe ato kane per fushen ne fjale.

Për pyetjen së çfarë penalitetesh janë vendosur, do te duhemi ti drejtohem degëve doganore (si entitete te vecanta) pasi ata kanë kompetenca vendimarrëse (rreth 27 te tilla dhe ne kete rast pergjigja jone do te duhet te marre me teper kohe nga pikepamja administrative).

Ne pergjithesi, legjislacioni parashtron se **në Pikat e Kalimit Kufitar** të gjithë personat të cilët hyjnë në/ose largohen nga territori i Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të deklarojnë shumat në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm të mbajtësit, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 10 000 euro ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera, qëllimin e mbajtjes së tyre, si dhe të paraqesë dokumente justifikuese përkatëse.

Deklarimi kryhet pranë zyrave të Administratës Doganore, në Pikën e Kalimit Kufitar, hyrje apo dalje. nëpërmjet formularit për raportimin e transportit të vlerave në kufi (RTVK) i cili plotësohet online pranë zyrave doganore në Pikat e Kalimit Kufitar.

Deklarimi i rremë apo i pasaktë apo mos deklarimi, bazuar në ligjin perkates, neni 17/1, Administrata Doganore ka të drejtën e vendosjes së gjobës.

Gjobat për mosdeklarim apo deklarim të rremë janë si më poshtë:

a) për shumat nga 10 000 - 19 999 euro ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera të huaja, gjoba është në shumën 20 000 (njëzet mijë) lekë për herën e parë, 10 % të vlerës së padeklaruar për herën e dytë, si dhe 30 % të vlerës së padeklaruar për rastet e tjera;

b) për shumat nga 20 000 – 49 999 euro ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera të huaja, gjoba është në shumën 40 000 (dyzet mijë) lekë për herën e parë, 20 % të vlerës së padeklaruar për herën e dytë, si dhe 40 % të vlerës së padeklaruar për rastet e tjera;

c) për shumat mbi 50 000 euro ose kundërvlera e tyre në monedha të tjera të huaja, gjoba është në shumën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për herën e parë, 30 % të vlerës së padeklaruar për herën e dytë, si dhe 50 % të vlerës së padeklaruar për rastet e tjera.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin, mbetemi të hapur për çdo pyetje/kerkese tjetër (nese do të keni) në lidhje me ceshtjet e mesiperme.